

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR

DHE

KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoritetit Kontraktor: Instituti i Mjekesise Ligjore
Adresa: Rruga e Dibrës nr. 370, Tiranë.

Ankesë drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik.

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

Avdul Gjoni - Person Fizik

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

M18929501J

Nuis/Nipt

Lagjia "Selam Musai", Rruga "Dule Dalani", ZK 3574, Nr. pasurie 56, godine 1- kateshe.

Adresa

Tepelenë

Shqipëri

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

+355683169924

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

avdulgjoni@yahoo.com

E-mail

Avdul Gjoni - Person Fizik

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Avdul Gjoni
Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar



2023/08/23

Data (viti/muaji/dita)

+355683169924

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

RF-P-77296-08-11-2023

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur

Procedurë e hapur e thjeshtuar

X

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje parapraketë njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Instituti i Mjekësisë Ligjore

4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

(Vlera e përlogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

13.205.500 (Trembëdhjetë milion e dyqind e pesë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër
(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).

Blerje reagente dhe materiale laboratorike

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

2023/09/01

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

8. Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Hartimi i DT është bërë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

-

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Krethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Njësia e hartimit të DT ka vendosur kritere kualifikimi të kundraligjshme të cilat kufizojnë konkurrencen e lirë dhe paracaktojnë fituesin e kësaj procedure.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Pasi u njohëm me DT të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje reagente dhe materiale laboratorike" konstatuam disa kritere kualifikimi jo të rregullta.

Bazuar në nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 97 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar po paraqesim këtë formular ankese duke kërkuar modifikimin e kritereve të kualifikimit.

Në kriteret e kualifikimit është kërkuar:

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertave të gjithë mostrat për zërat e kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit. Në rastin e përsëritjes së artikujve në lista mjafton 1 (një) mostër për artikull.

Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve të kërkuara në dokumentat e tenderit përbën kusht skualifikues.

Së pari, në procesverbalin e argumentimit të kritereve nuk është argumentuar teknikisht arsyeja e kërkesës për paraqitjen e mostrave. Autoriteti kontraktor është limituar në citimin e V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", ku përmenden mostrat, por pa argumentuar ndikimin që ka paraqitja e mostrave për vlerësimin e ofertës teknike. Gjithashtu, nuk ka asnjë kriter apo arsye se përse janë kërkuar mostrat për artikujt me "*" dhe jo për artikuj të tjerë.

Së dyti, këto janë artikuj specifikë që përdoren vetëm nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe si të tilla nuk janë artikuj stoku, të cilat disponohen në çdo kohë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender. Në këto kushte, duke qenë mallra importi dhe që prodhohen nga kompani të ndryshme ndërkombëtare, sigurimi i tyre është i pamundur të realizohet brenda datës së zhvillimit të tenderit, 01.09.2023. Gjithashtu, blerja e mostrave përbën kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët në rast se nuk kualifikohen këto mostra nuk mund t'i shesin, pasi janë produkte që përdoren vetëm nga IML.

Ky është një fakt diskriminues për operatorët ekonomikë të cilët synojnë të ofertojnë në këtë tender.

Nga eksperiencia jonë nuk është e nevojshme kërkesa për paraqitjen e mostrave për vërtetësinë e specifikimeve, kur është kërkuar në dokumentat e tenderit katalogu.

Në katalogun e markuar janë të përcaktuara të gjitha specifikimet e artikullit të ofruar, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Si konkluzion të argumentimeve të mësipërme, sjellim në vëmendje se këto mostra mund të disponohen në kohën e zhvillimit të tenderit, vetëm nga operatorë ekonomikë të cilët i kanë porositur ato shumë kohë përpara shpalljes së tenderit dhe që janë paracaktuar për ta fituar këtë tender.

Ky fakt bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit të prokurimit publik, me parimet që udhëheqin veprimtarinë e autoriteteve publike gjatë procedurave të prokurimit, duke kufizuar artificialisht konkurrencën, duke cënuar transparencën, si dhe duke favorizuar direkt ose indirekt operatorë të caktuar ekonomikë.

Në Shtojcën 5 "Specifikimet teknike" është kërkuar: *Për artikujt e shënuar me "**", ofertuesit duhet të paraqesin mostrat 2 orë para hapjes së ofertave, të cilat do të ruhen deri në momentin e lidhjes së kontratës.*

Kërkesa për paraqitjen e mostrave 2 orë përpara përfundimit të dorëzimit të ofertave është gjithashtu e kundraligjshme pasi dorëzimi i mostrave bëhet në datën dhe orën kur bëhet dorëzimi i ofertave.

Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit nuk ka argumentuar as teknikisht dhe as ligjërishit këtë kërkesë. Për ne është e qartë se vetëm në këtë mënyrë AK do të kuptoj se sa OE do të marrin pjesë në tender duke i dhënë kohë OE të përzgjedhur që të mund të ndryshojë ofertën në SPE. Kjo është në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 03 datë 12.04.2022 "Për procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE".

Kriteri në lidhje me paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt objekt-prokurimi është sipas parashikimeve të nenit 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, por nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë argument teknik, se përse kërkohet paraqitja e mostrave sikurse parashikohet në pikën 1 të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 03, datë 12.04.2022, "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë" dhe për më tepër ky kriter është një kriter i dubluar dhe që krijon kosto të shtuara për operatorët ekonomikë, pasi në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor për të krijuar bindjen se produktet e ofruara nga operatorët ekonomik ofertues do të jenë sipas specifikimeve teknike të dhëna në dokumentet e tenderit, ka përcaktuar që këta ofertues të paraqesin katalogët teknike për këto artikuj, ku të vërtetohet përputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të publikuara, prandaj autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën "F" të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, pasi nuk e ka argumentuar nga ana teknike vendosjen e këtij kriteri.

Sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit të kualifikimit për paraqitjen e mostrave si dhe heqjen e kërkesës për paraqitjen e disa mostrave 2 orë përpara hapjes së ofertave.

Ky është edhe qëndrimi i K.P.P. konkretisht:

Vendimi i KPP nr. 646/2022 datë 12.07.2022 mbi heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

Vendimi i KPP nr. 502/2023 datë 21.06.2023 mbi heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

Vendimi i KPP nr. 446/2023 datë 31.05.2023 mbi heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

Vendimi i KPP nr. 535/2023 datë 29.06.2023 mbi heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar: *Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40 % e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

- *Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera e kontratës dhe fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Në Nenin 2 "Qëllimi" të ligjit 162/2021 .Për prokurimin publik, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik...*

Ndërsa në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi...

Në Nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin public" parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...

Në nenin 40, pika 4 .Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public", i ndryshuar, parashikohet se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një osedisa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin epërvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara...

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën emëparshme.

Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, nëpërputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

Sa më sipër kërkojmë që autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter kualifikues sipas nenit 40, pika 4 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave" të V.K.M. Nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail: avdulgjoni@yahoo.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Person Fizik

Avdul Gjoni

